



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1730, datë 20.12.2011

Për

“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Albtelecom sh.a.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 20.12.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Albtelecom sh.a.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 120, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);

2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008,

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e AMC sh.a., me nr. 4213/3 prot. datë 3.11.2011, (AKEP: nr. 1709 prot., datë 3.11.2011) “*Ankim administrativ kundër operatorit Albtelecom sh.a tarifën e terminimit midis rrjeteve fikse të AMC dhe Albtelecom*”;
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);
- si dhe, duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

AMC sh.a., me anë të shkresës nr. 4213/3 prot. datë 3.11.2011, (AKEP: nr. 1709 prot., datë 3.11.2011) “*Ankim administrativ kundër operatorit Albtelecom sh.a tarifën e terminimit midis rrjeteve fikse të AMC dhe Albtelecom*”, sqaron si më poshtë:

AMC bën me dije se, pasi ka marrë autorizim të përgjithshëm dhe në bazë të kërkesave të saj më datë 10.05.2011, i është lëshuar nga AKEP autorizimi individual. Në zbatim të neneve 13, 20, 39, 47 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ka kërkuar akses dhe interkoneksion tek të gjithë operatorët e telefonisë fikse dhe mobile në mënyrë që shërbimi i ri t'i ofrohej publikut sa më shpejt.

AMC thekson se, me të gjithë operatorët e tjerë të cilët janë lidhur direkt me AMC si dhe me operatorët Mobile, negociimi i tarifave të terminimit, kontratat e interkoneksionit për AMC fiks, lidhja fizike e interkoneksionit, testet teknike dhe hapja e interkoneksionit, janë bërë brenda afateve të parashikuara në ligj si dhe në Rregulloren nr. 19, datë 14.06.2010 “Për Akses dhe interkoneksion”.

AMC vlerëson se, negociatat me Albtelecom sh.a janë vonuar jashtëzakonisht për shkak të mosmarrëveshjes për tarifën e terminimit në rrjetin e AMC fiks dhe të Albtelecom, duke parashtuar ecurinë kronologjike të marrëdhënies me Albtelecom, si më poshtë vijon:

AMC sh.a më datë 1.7.2011 ka njoftuar me anë të e-mail Altelecom për ofrimin e shërbimit publik të telefonisë fikse-e nga ana e AMC.

AMC sh.a me anë të shresës nr. 1401/6A prot, datë 1.7.2011 drejtuar Altelecom sh.a ka njoftuar mbi tarifën e terminimit në rrejtin fikse të AMC si për trafikun kombëtar ashtu edhe për trafikun ndërkombëtar, duke ndjekur parimin e simetrisë. Altelecom e tarifon AMC me 3.5 lek/min dhe 0.83 lek/thirrje, AMC e njoftoi Altelecom se do ta tarifonte me të njëjtën tarifë.

Altelecom përgjigjet me shkresën nr. 1401/6A prot, datë 15.7.2011 duke njoftuar se i ka përfshirë tarifën në draft marrëveshjen e interkoneksionit i dërguar nga Altelecom më 6.7.2011 e cila përmban tarifën simetrike për terminimet në rrjetet fikse respektive të Altelecom dhe AMC prej 3.5 lek/min dhe 0.83 lek/thirrje.

Altelecom më datë 4.8.2011 dërgon një e-mail në të cilën prezantohet fakti, që tarifën e pajtimtarit të Altelecom drejt rrejteve të tjera fikse (për pasojë edhe drejt numeracionit fikse të AMC) janë të rregulluara nga Vendimet e AKEP nr. 1348 dhe 1368.

AMC konsideron se, në kushte të tilla u detyrua që të pranonte tarifën e terminimit 1.5 lek/min në rrjetin e saj dhe të paguante 1.5, 2.5, dhe 3.5 lekë sipas segmenteve për terminimin në rrjetin e Altelecom duke nënshkruar Marrëveshjen e Interkoneksionit me Altelecom sh.a e depozituar në AKEP me nr. 1733 prot, datë 8.11.2011.

AMC thekson se, pas takimit në AKEP për këtë çështje, ku nga AKEP u citua pika 4 e Vendimit nr. 1348 për shpalljen e Altelecom OFNT, AMC prezantoi te Altelecom situatën dhe kërkoi ndryshimin e tarifës 1.5 lek/min në tre nivele në mënyrë që të plotësohej parimi i simetrisë.

Për sa më sipër, Altelecom përgjigjet se kjo pikë është e aplikueshme, në rast se, operatori palë e tretë është lehtësisht i dallueshëm nga pajtimtari dhe pajtimtari do të mund të ishte i vetëdijshëm që po thërret drejt një rrejt tjetër me tarifa më të larta. Në rastin e shërbimeve lokale fikse kjo është e pamundur pasi pajtimtari do t'i duhej të identifikonte një nga një të gjithë numrat e operatorëve të tjerë në zonën lokale përkatëse, dhe Altelecom me të gjithë operatorët e tjerë ka aplikuar të njëjtën tarifë, për më tepër, arranzhimet që Altelecom ka përfshirë në marrëveshjen e arritur, janë të natyrës tranzitore dhe siç kemi dakord do të jenë objekt i rikonsiderimit nga AKEP.

AMC ka dërguar shkresat zyrtare drejt AKEP nr. 4213 dhe 4213/1 prot, datë 2.9.2011 dhe trajton problemin e tarifës së terminimit për trafikun fikse-fikse mes Altelecom dhe AMC.

AMC kërkoi takim në AKEP për të diskutuar mbi këtë çështje dhe për të vënë në lëvizje AKEP në përmbushje të detyrimeve që organi rregullator ka në fushën e interkoneksionit. AKEP organizoi një takim dypalësh midis AMC dhe Altelecom, por sipas AMC nuk u arrit në një përfundim në lidhje me çështjen në fjalë.

AMC, konsideron se Altelecom ka mundësinë të shtojë një marzh fitimi në tarifën e terminimit, për këtë arsye AMC i propozoi Altelecom dy alternativa. Për tarifa që do të ishin simetrike në nivelin 1.5 lek/min, 2.5 lek/min dhe 3.5 lek/min plus tarifën filltare të thirrjes në varësi të vendndodhjes (lokale, rajonale apo racionale) dhe alternativa tjetër ishte që tarifën jashtë Tiranës të ishin simetrike në nivelin 3.5 lek plus tarifën fillestare të thirrjes, më pas Altelecom mund të shtojë shumën e rezervuar për ata si marzh fitimi, të aprovuar nga AKEP në Vendimin nr. 1182, datë 10.03.2010.

AMC thekson se, Albtelcom nuk ka pranuar asnjërën nga alternativat e propozuara. AMC tashmë ka hedhur në treg produktin e telefonisë fikse dhe ky produkt mund të ofrohet në kushte më të mira për përdoruesin.

Së fundmi AMC bazuar në nenet 7, 8, 13, 15, 20, 39, 47, 49, 51, 60 të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në RSH”, kërkon që AKEP në kuadër të këtij procedimi administrativ të konstatojë që qëndrimi i Albtelcom nuk është në përputhje me dokumentat rregullatorpër shpalljen e Albtelcom si OFNT (Vendimi nr. 1348), dhe të urdhërojë ndryshimin e pjesës përkatëse të MI sipas kërkesës së AMC.

Duke qënë se, sipërmarrësit AMC sh.a dhe Albtelcom sh.a megjithë negociatat, dhe përpjekjet e bëra, nuk kanë arritur të bien dakord për ndryshimet e propozuara nga AMC sh.a në Marëveshjen e Interkoneksioni të lidhur midis tyre, AKEP në zbatim të nenit 120 dhe në vijim të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, zgjidhja e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me inisiativën e AKEP,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Albtelcom sh.a;
 2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me përbërje si:
 - Altin RRAPAJ Kryetar
 - Jonida GJIKA Anëtare
 - Jetmir BRAHA Anëtar
 - Ded JAKAJ Anëtar
 - Esmeralda DERVISHI Anëtare
 3. Të njoftohen palët e interesuara Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Albtelcom sh.a, për fillimin e procedimit administrativ;
 4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
 5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al
- Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Alketa MUKAVELATI**
- 3. Benon PALOKA**
- 4. Zamira NURÇE**